



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPublika e Kosovës - REPUBLICA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Pranuar - Pranimje: 16.04.2019			
Nr. i organit Org. broj	Numri i Broj	Shtetëci Drilog	Vlera Vrednos
02-035/02-398			

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Anex Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të "Caritas Kosova" dhe Komunës së Vitisë nr 02-035/02-672 të datës 09.07.2018, për projektin: Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmur dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 20.000,00 € NË EMËR TË BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmur dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018"

I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë ndan mjete financiare në shumë prej **20.000,00 € (Njëzetmijëeuro)** në emër të bashkëfinancimit për realizimin e projektit "Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmur dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018", bazuar në Anex Marrëveshjen për bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes të "Caritas Kosova", dhe Komunës së Vitisë numër 02-035/02-672 të datës 09.07.2018.

II.

Mjetet nga neni I i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2019 nga kodi për mallra dhe shërbime – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –për pagesën e Faturës PSHV14/2018 të datës 15.04.2019.

Mjetet nga neni I i këtij vendimi derdhen në llogari të "Caritas Kosova".

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti, më 16.04.2019

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

